



RAPORTIMI I PAVARUR I MEDIAVE GJATË FUSHATAVE ZGJEDHORE DHE SFIDAT E GARANTIMIT TË TRANSPARENCËS

Ky dokument u prodhua si pjesë e iniciativave publike të pjesëmarrësve dhe alumnëve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike”. Mendimet, gjetjet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Akademisë së Studimeve Politike, si zbatuese e këtij programi.

NENTOR 2024

**AUTORËT: ESIONA KONOMI
ANILA HOXHA
EVEREST DEDAJ**



SHKURTIME

Kodi-Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

OSBE-ODIHR-Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Zyra pr Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

KQZ-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

AMA-Autoriteti i Medias Audiovizive

MVZ-Misioni i Vëzhguese Zgjedhorë (ODIHR)

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE
Rr. Emin Duraku, Pallati Credins, kati 7, Tiranë
Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al
web: www.asp.al

1. Hyrje

Ky punim ka për qëllim të analizojë rrafshin ligjor dhe situatën faktike të aksesit të medias në aktivitetet elektorale të partive dhe kandidatëve gjatë fushatave zgjedhore. Dokumenti vlerëson mundësisë së gazetarëve për të raportuar në mënyrë të pavarur e për të transmetuar materiale autentike të prodhuara nga vetë ata. Materiale i referohet kuadrit ligjor shqiptar, kryesisht Kodin Zgjedhor si dhe rekomandimeve të vëzhguesve ndërkombëtare në raportet e OSBE-ODIHR. Analiza merr në konsideratë pasojat e një raportimi mediatik të deformuar apo dezinformim në krijimin e perceptimeve të gabuara tek votuesit, duke ndikuar në nivelin e demokracisë. Rekomandimet që vijnë si rezultati i këtij raporti, kanë si objektiv kryesor Kuvendin e Shqipërisë dhe organin përgjegjës për reformën zgjedhore. Ky dokument vlen si një ftesë për partitë politike për të aplikuar praktika më të mira e po ashtu i adresohet Autoritetit të Mediave Audiovizive për të vendosur rregulla më të qarta për dallimin e imazheve të prodhuara nga subjektet elektorale.

2. Konteksti

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta e shprehjes është e garantuar, epo ashtu edhe e drejta për të kryer veprimtari politike.

[Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë](#), njeh në nenin 6 të tij, të drejtën e medias për të caktuar vëzhgues në zgjedhje. “Organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, **përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias** kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje”, -thuhet në Kodi.

Ai garanton më tutje në nenin 78, se përcaktimet ligjore “kanë qëllim garantimin e barazisë së subjekteve zgjedhore në garë, sigurimin e paanësisë së operatorëve radiotelevizivë në raport me fushatën dhe subjektet e veçanta zgjedhore, si dhe mbrojtjen e subjekteve zgjedhore nga praktiket e deformimit të mesazhit zgjedhor, censurës dhe përdorimit të kundërligjshëm të medias”.

Por praktika e 10 viteve të fundit, ka treguar se partitë politike, kryesisht dy partitë më të mëdha, nuk lejojnë që gazetarët, kameramanët apo fotografët të ndjekin nga afër takimet elektorale, të regjistrojnë veprimtarinë e kandidatëve, të bëjnë filmime të pavarura apo të intervistojnë pjesëmarrësit. Gazetarët kanë dëshmuar gjithnjë e më fortë se hapësirat e tyre thuajse janë zëruar për ta ndjekur nga afër fushatën zgjedhore. Kasetat e dikurshme me materiale të gatshme audiovizuale, tashmë janë zëvendësuar me lidhje elektronike ku mund të shkarkohet aktiviteti, ose ngjarjet transmetohen drejtpërdrejt në rrjetet sociale të kandidatëve.

Reporterët kanë vërtetuar se në zgjedhjet e fundit bashkiake, ato të vitit 2023, në Tiranë vetëm një kandidat e ftoi dhe e lejoi median lirshëm të ishte e pranishme në terren.

Pamjet e gatshme të prodhuara nga subjektet zgjedhore nuk përmbajtën një panoramë të plotë të ngjarjes. Ato përfshinin montazh të ngjeshur, duke servitur fjalë të përzgjedhura e protagonistë të përzgjedhur. Të gjitha materialet e gatshme në çdo rast dhe të çdo krahu, nuk kanë pasqyruar debate brenda grumbullimit partiak duke censuruar zërin kritik mes militantëve apo qytetarëve.

Në ato raste, kur mediat kanë tentuar të shkojnë e të ndjekin nga afër aktivitetet, kryesisht të liderëve politikë, ata nuk janë lejuar nga forcat e sigurisë apo nga zyra e shtypit, e cila, ka lënë si opsion të vetëm pamjet e gatshme me “regji”. Për arsye të ndryshme, media i është dorëzuar këtij standardi, edhe pse Shoqatat e Gazetarëve, vendas apo të huaj, e kanë kritikuar këtë praktikë dhe këto shqetësime janë gjetur me vend nga raportet e OSBE-ODIHR. Kodi Zgjedhor, në nenin 84 të tij, thotë se “informacionet mbi aktivitete të fushatës zgjedhore, që përgatiten dhe transmetohen në edicionet informative, **bazuar në materiale të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore**, duhet të identifikohen qartë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së”.

I njëjti nen, në pikën “d”, specifikon se media audiovizive përgatit lajmet në liri të plotë editoriale. “Kur **për shkaqe objektive** media nuk është në gjendje të ndjekë veprimtari të veçanta zgjedhore, ajo lejohet të

shfrytëzojë dhe përzgjedhë pamje filmike nga **regjistrimet e plota** të servirura nga subjektet zgjedhore, me kushtin që ta shoqërojë lajmin me shënimin “materiali filmik servirur nga subjekti...”.

Megjithëkëtë, monitorimet kanë provuar se ky nen nuk është zbatuar, dhe në vend të shenjës dalluese “materiali filmik servirur nga subjekti...” janë vendosur logo të partive përkatëse, ose numri rendor i partisë/kandidatit në fletën e votimit. Neni 84, pika “d” e Kodit Zgjedhor, parashikon se vetëm kur media “për shkaqe objektive” nuk ndjek dot veprimtarinë elektorale, ajo mund të përdorë “regjistrimet e plota”. Në terren, gazetarët dëshmojnë se nuk lejohen ta ndjekin aktivitetin, ndërsa materialet nuk janë gjithmonë të plota e në një masë të madhe përmbajnë montazh.

[Autoriteti i Mediave Audiovizive](#), monitoron fushatat elektorale për zbatimin e detyrimeve të Kodit Zgjedhor, dhe të dhënat i referohen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e masave administrative. Deri më tani, KQZ ka vendosur gjoba për kohë të pa balancuar vënë në dispozicion kandidatëve, por jo për aspekte të tjera, si: moslejimi i medias të ndjekë aktivitetin elektorale, e as për mos vendosjen e shënimit “materiali filmik servirur nga subjekti...”.

Kjo situatë problematike që cënon lirinë e medias dhe rrezikon të prodhojë mesazh të deformuar tek votuesit është pasqyruar edhe në rekomandimet e posaçme të OSBE/ODIHR.

“Ekziston një praktikë e përhapur gjerësisht tek partitë kryesore politike dhe institucionet publike për t'u siguruar mediave pamjet e regjistruara paraprakisht ose pamje të drejtpërdrejta të ngjarjeve politike dhe të fushatës. Këto filmime përdoren gjerësisht nga transmetuesit në programet e tyre, duke përfshirë edhe në lajme, shpesh pa shënimin e duhur.⁹² Të gjithë bashkëbiseduesit e mediave të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se kjo praktikë ndikon ndjeshëm në pavarësinë editoriale, pasi mediat, në vend që ta prodhojnë vetë përmbajtjen, mbështeten shumë në këto materiale. (shih gjithashtu pjesën Gjetjet e Monitorimit të Medias)”, -thuhet [në raportin e ODIHR, për zgjedhjet e vitit 2023](#).

Sipas të njëjtit dokument, rreth 38 për qind e mbulimit të lajmeve të monitoruara u konfirmuan ose kishin gjasa të ishin materiale të prodhuara nga partitë. “Vetëm 5 për qind e këtij materiali ishte shënuar në përputhje me Kodin Zgjedhor”. Ky raport, e vendos këtë çështje mes rekomandimeve prioritare, ku në rekomandimin nr.8 thuhet: “Përdorimi nga media i materialeve të prodhuara nga partitë ose autoritetet shtetërore në programet e lajmeve dhe informacionit duhet të shmanget ose të kufizohet në raste të jashtëzakonshme, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Sa herë që transmetohen materiale të tilla, duhet të identifikohen qartësisht si përmbajtje e prodhuar nga garuesit politikë siç kërkohet me ligj. Për shkeljet që lidhen me kërkesat e ligjit për identifikimin e këtyre materialeve të gatshme duhet të parashikohen sanksione dhe duhet të zbatohen”.

Kjo panoramë është e mbartur që nga [viti 2021, raport në të cilin, ODIHR](#) sërish tregonte konsiderata të ngjashme kritikuese.

“Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, neni 84.1 i Kodit Zgjedhor ende lejon që filmimet e pararegjistruara të prodhuara nga partitë të transmetohen gjatë dhënies së lajmeve. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së së ODIHR-it e kritikuan këtë praktikë të hershme dhe të përhapur të partive kryesore politike dhe zyrtarëve publikë për t'u ofruar mediave regjistrime të gatshme të parapërgatitura ose regjistrime të drejtpërdrejta të aktiviteteve të tyre. Duke interpretuar ngushtë ligjin dhe rregulloret e KQZ-së, transmetuesit shpesh zgjedhën të mos merrnin pjesë në ngjarjet e fushatës, gjë që rezultoi në mungesë të mbulimit gjithëpërfshirës dhe objektiv të subjekteve dhe bëri të paqartë ndarjen midis përmbajtjes editoriale dhe reklamës politike. Kjo është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e Këshillit të Evropës”, -thuhet në raport.

Në rekomandimet e vitit 2021, ODIHR rekomandonte ndryshime ligjore të cilat ende nuk kanë ndodhur:

“Legjislacioni duhet të ndryshohet për t’u siguruar që mediat të jenë në gjendje të mbulojnë në mënyrë të pavarur aktivitetet e subjekteve zgjedhore me qëllim kufizimin e përdorimit të përmbajtjes së prodhuar nga partitë në lajme”.

Nuk ekzistojnë praktika të ngjashme ndërkombëtare apo rajonale ku kuadri ligjor të përfshijë “Materiale filmike të serviuara” apo praktika për pengimin e medias të ketë akses të drejtpërdrejtë në aktivitete elektorale. Qeveria e Shqipërisë është e vetdijshme se aktet rregullatore në fushën e medias gjatë fushatave zgjedhore janë një indikator kyç për avancimin e procesit të integritetit. Në dokumentin [“Udhërrëfyese për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”](#), linja e dytë titullohet “Media në fushatën zgjedhore”.

Ndër të tjera, thuhet se duhet të merren parasysh: rëndësia e mediave autonome dhe pluraliste, roli vendimtar i transmetuesve të shërbimit publik, ndarja e veprimtarive politike nga interesat mediatike të politikanëve që janë pronarë të medias, mbrojtja e të drejtave hetimore të gazetarëve dhe respektimi i tyre, pavarësia redaksionale, si dhe parandalimi kundër përdorimit të mundshëm të burimeve publike nga qeveritë dhe institucionet publike për të ndikuar në përmbajtjen mediatike.

Qeveria i njej vetes detyrën për të bërë ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor për:

“të garantuar mundësi të barabarta për të gjitha palët konkurruese për të pasur qasje në media, përfshirë hapësirën reklamuese dhe adresimin e mbulimit të fushatës mediatike me materiale të gatshëm të ofruar nga partitë, duke përfshirë monitorimin e mediave sociale të miratuar brenda vitit 2024, pas një procesi konsultimi publik”.

[“Udhërrëfyese për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”](#) pohon se do të garantohet *“Rritja e monitorimit dhe profesionalizmit sasior dhe cilësor në raportimin mediatik (duke përfshirë materiale të gatshme nga partitë politike) të medias gjatë fushatës zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, si dhe kapacitetet e AMA-s për të kryer monitorimin në mënyrën e duhur, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, nëpërmjet zbatimit të “Modernizimit të studios së monitorimit” nga AMA”* Dhe *“Adresimi i rekomandimeve të pazbatuara të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera.”*

1. Rekomandime

3.1-Për Kuvendin e Shqipërisë, organi përgjegjës për reformën zgjedhore

Kuvendi i Shqipërisë, përmes organeve përgjegjëse për reformën zgjedhore, sipas rastit përmes komisionit të posaçëm për këtë çështje, duhet të ndërhyjë në Kodin Zgjedhor dhe të korrigjojë nenin 84 të Kodit Zgjedhor, duke sanksionuar të drejtën e pamohueshme të medias për të ndjekur nga afër aktivitetet elektorale të subjekteve zgjedhore. Kuvendi është përgjegjës për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të ODIHR, ku bëjnë pjesë edhe ato për mjedisin mediatik. Kuvendi duhet të çojë përpara zotimet që janë bërë në dokumentin [“Udhërrëfyese për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”](#), duke ndërmarrë hapat e duhur ligjor, përfshirë ato që trajtojnë në përputhje me standardet më të mira raportimet mediatike në fushata zgjedhore, e specifikuara transmetimin e materialeve të gatshme. Të garantohet zbatimi i pikës “d”, neni 84, ku përdorimi i materialeve të gatshme të jetë një përjashtim nga rregullit dhe jo një rregull, duke përforcuar nenin me elementë që detyrojnë partitë që materialet filmike të sevirura, janë të plota dhe të papërpunuara. T’i jepet medias e drejta, që në rastet kur punonjësit e saj nuk janë lejuar të jenë pjesë e një aktiviteti elektorale, e në rast se materiali i servitur dallohet të jetë i montuar, të refuzohet transmetimi i tij dhe kjo të mos llogaritet si penalitet pasi është shkaktuar disbalancë në minutazh në raport me kundërshtarët. Kuvendi duhet të marrë

masa për të luftuar dezinformimin në përputhje me Udhërrëfyesin, duke vënë një fokus të veçantë edhe tek informacioni i rremë që mund të prodhohet nga partitë përmes materialeve të gatshme, të cilat duke u shpërndarë në media, mund të krijojnë kuptime të gabuara tek votuesit. Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”, përmes gjithëpërfshirjes, duhet të konsiderojë si prioritet përpara zgjedhjeve të vitit 2025, por edhe në vazhdim, marrjen e masave për të parandaluar shpërndarjen e strukturuar të informacionit të rremë me qëllim krijimin e avantazhit elektoral.

3.2-Për Autoritetin e Mediave Audiovizive

Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të marrë masa përpara çdo fushate zgjedhore për të ndërgjegjësuar operatorët mediatikë për të respektuar detyrimet e Kodit Zgjedhor dhe për të vendosur në mënyrë të patjetërsueshme shënimin ““materiali filmik servirur nga subjekti...” mbi çdo produkt që është vënë në dispozicion nga subjekte garuese. AMA nuk duhet të lejojë zëvendësimin e këtij shënimi të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, me shenja të tjera të cilat mund të jenë logoja e partisë apo numri i subjektit zgjedhor në fletën e votimit, duke shmangur kështu paqartësinë që mund të krijohet në këtë rast tek votuesi.

AMA duhet të aplikojë penalitete sipas ligjit për shkeljen e këtyre detyrimeve, si dhe të hartojë një raport të veçantë në fund të çdo fushate zgjedhore ku të shfaqen subjektet elektorale dhe operatorët mediatikë që nuk i janë përmbajtur detyrimit.

3.3-Për Partitë Politike

Partitë Politike ftohen të ndjekim praktikën më të mirë të partive të tyre simotra në vendet me demokraci të zhvilluar. Ato duhet të respektojnë ligjet në fuqi dhe të bëhen promotorë të përmirësimeve të tjera ligjore që rrisin transparencën gjatë fushatave elektorale dhe të krijojnë një akses më të plotë të medias në aktivitetet e tyre. Partitë Politike dhe kandidatët duhet të lejojnë median të ndjekë nga afër takimet e tyre elektorale për sa kohë ato janë me pjesëmarrjen e publikut. Kjo duhet të kryhet pa asnjë pengesë e sa herë që gazetarët e kërkojnë. Ekzistenca e një produksioni të vetë subjektit elektoral që transmeton material filmik, qoftë edhe të drejtpërdrejtë të aktivitetit, nuk duhet të jetë kusht që të pengohet hyrja e reporterëve dhe videoreporterëve. Mes stafeve të subjekteve elektorale dhe punonjësve të shtypit duhet të ekzistojë një bashkëpunim reciprok, i cili nga njëra anë lejon mbarëvajtjen e aktivitetit elektoral, e nga ana tjetër, lejon median të dëshmojë, regjistrojë dhe raportojë në mënyrë të paanshme e të balancuar. Partitë Politike duhet të braktisin praktikën e manipulimit të mesazhit në çdo kohë, e sidomos gjatë fushatës zgjedhore.

